

## VENDIM

Datë 16/11/2022

### I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "PRESTIGE ACQUA OLIGOMINERALE" SH.P.K.

Sot me datë 16/11/2022, në orën 12:00 në selinë e shoqërisë "Prestige Acqua Oligominerale" sh.p.k, u thirr mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

Duke qenë se:

A. Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Prestige Acqua Oligominerale" sh.p.k, Asambleja vendosi në pikën 1 dhe 2 si vijon:

1. Miratimin e përjashtimit të ortakut "Prestige Immobiliare" S.A. me pjesmarje prej 50% të kuotave, nga shoqëria "Prestige Acqua Oligominerale" sh.p.k.;

2. Miratimin për vijueshmërinë e procedurave pranë organeve publike për përjashtimin e ortakut "Prestige Immobiliare" S.A.

B. Padia për përjashtimin e ortakut "Prestige Immobiliare" s.a. është depozituar dhe më pas shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

C. Me vendimin Nr. 2418, datë 05.05.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur si vijon:

1. **"Pranimin e padisë.**

2. Miratimin e Vendimit të Asamblesë së Shoqërisë "Prestige Acqua Oligominerale" sh.p.k date 05.06.2019 për përjashtimin e ortakut "Prestige Immobiliare" s.a. nga shoqëria "Prestige Acqua Oligominerale" sh.p.k.

Bazuar në Vendimin Nr. 2418, datë 05.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (i cili ka marrë formë të prerë në datën 15.11.2022) dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar,

Asambleja e Shoqërisë "Prestige Acqua Oligominerale" sh.p.k.,

### VENDOSI:

1. Anullimin e një kuote të shoqërisë, me vlerë 50.000 Lekë, të zotëruar nga ortaku "Prestige Immobiliare" s.a, përjashtimi i të cilit është miratuar me anë të vendimit gjyqësor të formës së prerë;

2. Ndryshimin e numrit të ndarjes në kuota të kapitalit: nga 2 kuota, në 1 kuotë të zoteruar nga

Ortakja e vetme **Sofije Merkaj**;

3. Regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME  
E ORTAKUT TË VETËM**

*Sofije Merkaj*

Sofije Merkaj

